



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Laborator teorik dhe praktik për Shkrimin e Proves Finale

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare

Viti /Semestri: viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi i Gjuhës Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë”

Kodi i etikës :Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të zhvillojë aftësitë kërkimore të studentëve për të konceptuar, planifikuar dhe realizuar një punim përfundimtar në mënyrë të pavarur. Të orientojë studentët drejt një analize kritike të burimeve dhe të dhënave relevante për temën e tyre të kërkimit. Të përforcojë përdorimin e metodave të përshtatshme për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave në kontekstin e mësimdhënies së gjuhës greke. Të nxisë një qasje profesionale dhe akademike ndaj procesit të shkrimit dhe paraqitjes së tezës së diplomës.

Objektivat specifike lëndore:

1. Përzgjedhin dhe formulojnë një temë të përshtatshme për provën finale në fushën e mësimdhënies së gjuhës greke.
2. Hartojnë një strukturë logjike dhe të argumentuar të tezës, në përputhje me kriteret akademike.
3. Aplikojnë teknikat e kërkimit shkencor për të mbledhur dhe analizuar të dhëna relevante.
4. Përdorin në mënyrë korrekte citimet dhe referencat sipas standardeve të përcaktuara.
5. Shkruajnë dhe redaktojnë tekstin akademik në mënyrë koherente, të qartë dhe profesionale.
6. Prezantojnë gjetjet kryesore të punës së tyre me qartësi, argument dhe vetëbesim.